



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:154804

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05503994

Ac.nr.7435/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Liridon Maloku dhe Fatmir Baloku, antarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N. (L.) K. nga fshati Sh. e P., Komuna e K., të cilin me autorizim e përfaqëson E. A., avokat nga K., kundër të paditurit I. (M.) B. nga fshati Sh. e P., Komuna e K., të cilin me autorizim e përfaqëson F. B., avokat nga Gj., me objekt kontesti për vërtetimin e së drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga paditësi, ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat E. A.i, avokat nga Kamenica, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 111/2017, të datës 28.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **25.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET SI E BAZUAR ankesa e paditësit N. K. nga fshati Sh. e P./Kamenicë, ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat E. A. nga Kamenica, ashtu që: **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.111/2017, i datës 28.08.2023, dhe çështja i kthehet në **ri vendosje**, gjykatës së shkallës së parë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e ankimuar C.nr. 111/2017, i datës 28.08.2023, ka vendosur si në vijim:

I. KONSIDEROHET se është tërhequr padia e paditësit N. (L.) K. nga fshati Sh. e Poshtme, Komuna e Kamenicës, e datës 27.06.2017, e parashtruar kundër të paditurit I.(M.) B. nga fshati Shipashnicë e Poshtme, Komuna e Kamenicës, për vërtetimin e së drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit prej 900.00 euro.

II. Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë ka paraqitur paditësi N.K., përmes të autorizuarit të tij, avokat E. A. nga Kamenica, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të themeltë dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

I padituri, nuk ka ushtruar përgjegje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas ekzaminimit të ankesës së të paditurës së dytë, shqyrtimit dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 pika (d), të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësit N. K. nga fshati Sh. e P./K., ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat Enver Ajvazi nga Kamenica është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi N. K. nga fshati Sh. e P./Komuna e K., përmes të autorizuarit të tij, avokat E. A. nga K., me datën 27.06.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi kundër të paditurit Murat dhe Imer të dy me mbiemrin B. nga fshati Shipashnicë e Poshtme/Komuna e Kamenicës, përmes së cilës ka kërkuar nga gjykata që të detyrohen të paditurit që paditësit t'ia kthejnë ngastrën kadastrale të përshkruara si në petitumin e padisë.

Të paditurit, M. dhe . të dy me mbiemrin B., përmes të autorizuarit të tyre, avokat F. B. nga Gjilani, brenda afatit ligjor kanë ushtruar përgjigje në padi, përmes së cilës e kanë kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit me pretendimet se ngastrat lëndore që pretendon se i ka blerë paditësi, këto ngastra kadastrale qysh para 45 viteve i ka blerë i padituri i parë Murat B., i cili njëkohësisht është edhe babai i të paditurit të dytë I. B., mbi bazën e këtyre arsyeve, gjykatës i kanë propozuar që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, ka caktuar seancë përgatitore dhe pas saj edhe seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë dhe administruar provat me dëgjimin e dëshmitarëve, daljen e gjykatës në vendin e ngjarjes dhe nxjerrjen e provës me anë të ekspertizës, ashtu që, gjatë fazës së shqyrtimit kryesor, i autorizuari i të paditurëve avokat Faruk Brestovci, e ka njoftuar gjykatës se i padituri i parë M.B. ka ndërruar jetë dhe nga certifikata e vdekjes së prezantuar nga i njëjti, vërtetohet se M. B. ka vdekur me datën 16.01.2022, ashtu që, gjykata e shkallës së parë pas konstatimit të këtij fakti nxjerr aktvendimin C.nr.111/2017, të datës 24.01.2022, me të cilin në pikën I të dispozitivit të tij, procedurën gjyqësore e ndërpreu në këtë çështje juridike për shkak të vdekjes së të paditurit të parë M. B., dhe në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi konstaton se procedura e ndërprerë gjyqësore do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozim të palës kundërshtare.

Ndërkohë, me parashtresën e dorëzuar në gjykatë me datën 04.02.2022, paditësi N. K., përmes të autorizuarit të tij, avokat E.A. nga K., ndryshon në kuptim subjektiv padinë e padinë e ushtruar, duke kërkuar që si palë e vetme në këtë çështje juridike të mbetet i padituri I. B., ngase ai i ka në posedim ngastrat kontestuese, edhe pse i ndjeri M. B. përveç tij pas vetes ka lënë edhe bashkëshorten e tij dhe të birin e tij N. B. i cili jeton në botën e jashtme.

Gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të parashtrës nga ana e palës paditëse, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 13.04.2023, ashtu që, në këtë seancë gjyqësore i autorizuari i paditësit e ka informuar gjykatën për trashëgimtarët e të ndjerit M. B. ku përveç të paditurit I.B. si trashëgimtarë tjerë ligjor janë edhe bashkëshortja e tij (pa e emërtuar me emër), e cila deklaron se jeton në Gjilan te vajza e saj, si dhe i biri i tij N. B. për të cilin deklaron se jeton në Gjermani, ndërsa i autorizuari i të paditurit I. B. avokat F. B. në fjalën e tij deklaron se i ndjeri M. B. përveç të paditurit I. B. pas vetes ka lënë bashkëshorten D. B., djalin Naser B. i cili jeton në Gjermani dhe 3 vajza tjera (për të cilat nuk i emërton me emra), dhe njëkohësisht, ka deklaruar se do të kërkoj nga i padituri I. B. që të përpiloj aktvdekjen për të ndjerin M.B., në mënyrë që të dihet saktësisht numri i trashëgimtarëve ligjor.

Gjykata e shkallës së parë, pas dëgjimit të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, në seancën e datës 13.04.2023, nxjerr aktvendim me të cilin e detyron të paditurin I. B. që në afat prej 30 ditësh të përpiloj aktvdekjen për të ndjerin M.B., duke kërkuar nga i njëjti që në aktvdekje të futen të gjithë trashëgimtarët e mundshëm të të ndjerit dhe të dihet saktë numri i tyre, dhe pas dorëzimit aktvdekjes, të njëjtën do t'ia përcjellë palës paditëse në mënyrë që e njëjta ta ketë të qartë se kënd do ta fut si palë e paditur, njëkohësisht në dispozitiv të këtij aktvendimi është vendosur që pas eliminimit të pengesave ligjore gjykata do të vazhdoj procedurën gjyqësore në këtë çështje juridike

Nga provat në shkresat e lëndës nuk vërtetohet se i padituri I. B. ka vepruar sipas detyrimit të gjykatës së dhënë përmes aktvendimit nga seanca e datës 13.04.2023 që i njëjti brenda afatit 30 ditor të përpiloi aktvdekjen për të ndjerin M. B. me përfshirjen e të gjithë trashëgimtarëve të mundshëm ligjor në mënyrë që të dihet saktësisht numri i tyre dhe pas kësaj gjykata t'ia dorëzoi palës paditëse dhe të kërkoj njëkohësisht edhe rregullimin e padisë në aspektin e legjitimitetit pasiv.

Ndërkaq, gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar C.nr.111/2017, të datës 28.08.2023, jashtë seancës nxjerr aktvendim me të cilin padinë e paditësit kundër të paditurit e konsideron të tërhequr, ndërsa për shpenzimet e procedurës vendos që secila palë ti bartë shpenzimet e saj të procedurës.

Në arsyetimin e dhënë lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se gjykata, me aktvendimin procedural të seancës përgaditore të datës 13.04.2023, e ka obliguar palën paditëse, që brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi procedural, t'a rregullojnë legjitimitetin real pasiv të palëve të paditura në këtë procedurë, konform aktvdekjes të përpiluar në emër të babait të të paditurit, tani të ndjerit M. B., dhe njëkohësisht përmes këtij aktvendimi procedural palA paditëse është njoftuar se në qoftëse nuk vepron sipas obligimit dhe brenda afatit të lartëcekur, gjykata do t'a konsideroj si të tërhequr padinë e paditësit.

Ndërsa në anën tjetër, duke e pasur parasysh afatin gjyqësor prej 30 ditësh, të dhënë nga gjykata, në mënyrë që brenda këtij afati paditësi t'a përmbush obligimin e lartëcekur, reepektivisht t'a bëjë rregullimin e legjitimitetit real pasiv të palëve të paditura në këtë procedurë, konform aktvdekjes së tani të ndjerit M. B., në mënyrë që gjykata të mund të veprojë pa pengesa ligjore

në këtë çështje juridike kontestimore dhe të komunikoj me rregull me palën e paditur, paditësi edhe përkundër faktit që ka qenë i njoftuar përmes procesverbalit të seancës gjyqësore të lartëcekur, që t'a përmbushin obligimin e lartëcekur brenda afatit prej 30 ditësh, i njëjti as edhe pas kalimit prej 4 (katër) muajve nga dita kur e ka pasur për obligim që ta përmbushin obligimin e lartëcekur, nuk e ka përmbushur të njëjtin, respektivisht nuk ka kthyer asnjë lloj përgjigje lidhur me obligimin ligjor të marrë nga gjykata, e rrjedhimisht gjykata nuk ka mundur të veproj më tutje me procedimin e kësaj çështje juridike kontestimore, andaj, edhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Andaj, gjykata duke e pasur parasysh se pala paditëse, nuk e kanë përmbushur obligimin ligjor brenda afatit prej 30 ditëve nga dita kur e kanë marrë obligimin e lartëcekur, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 99 paragrafi 2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku përcaktohet se *“Parashtrësat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashtruesit”*, si dhe në dispozitën e nenit 102 paragrafi 3, të po këtij ligji, ku përcaktohet se *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësa do të hidhet poshtë”*, gjykata e konsideroj si të tërhequr padinë e paditësit dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartëcekurat, e konform nenit 99 paragrafi 2 dhe 102 paragrafi 3, e lidhur me nenit 261, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, tani për tani nuk e pranon si të drejtë dhe qëndrueshëm, edhe pse i njëjti aktvendim nuk është shoqëruar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.2 të LPK-së dhe atë pika b), g), j), k) dhe m), për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, megjithatë, i njëjti aktvendim është i shoqëruar me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n), si dhe nenit 182 par.1, që lidhet me nenin 277 pika a), në lidhje me nenin 282, në lidhje me nenin 102, par.1 dhe 3 si dhe nenin 261, të LPK-së, e që të njëjtat kanë ndikuar në mos vërtetimin e drejtë dhe plotë të gjendjes faktike, për çka aktvendimi i ankimuar është anuluar.

Gjykatës së Apelit, i rezultojnë të bazuara pretendimet ankimore të palës paditëse se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr, kjo për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vepruar kur ka nxjerr aktvendimin e ankimuar për tërheqje të padisë së paditëse, ngase me aktvendimin e dhënë në seancën të datës 13.04.2023, gjykata e ka urdhëruar palën e paditur I. B. që në afat prej 30 ditësh të përpiloj aktvdekjen për të ndjerin M. B., së bashku me detyrimet tjera, dhe gjithashtu është vendosur që pas përpilimit dhe dorëzimit të aktvdekjes nga ana e të paditurit, e njëjta do ti dërgohet palës paditëse në mënyrë që e njëjta ta ketë të qartë se kënd duhet ta përfshijë si trashëgimtarë të mundshëm ligjor të të ndjerit M. B., dhe meqë, i padituri I. B. nuk ka prova se ka vepruar sipas urdhërit të gjykatës, atëherë, nuk janë plotësuar as kushtet ligjore që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr, sepse paditësi për rregullimin e padisë sipas

aktvendimit procedural të nxjerrë në seancën e datës 13.04.2023, fillimisht ka qenë dasht ti dorëzohet aktvdekja e siguruar brenda afatit 30 ditor nga i padituri I. B., prandaj, në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vendosur kur ka konstatuar se në rastin konkret janë krijuar kushtet ligjore për tërheqje të padisë së paditësit, ngase kushtet ligjore për tërheqje të padisë së paditësit krijohen kur paditësi e merr detyrimin që si i vetëm të bëjë diçka apo përmbushë sipas detyrimit të gjykatës pa qenë i varur nga ndonjë detyrim paraprak i të paditurit apo subjekteve tjera në procedurë apo jashtë saj, e që në rastin konkret paditësi ka qenë i varur nga sigurimi i aktvdekjes nga i padituri në mënyrë që të rregulloj në kuptimin e legjitimitetit pasiv padinë e ushtruar duke përfshirë të gjithë trashëgimtarët e mundshëm ligjor të të ndjerit M. B. si palë e vetme-bashkëndërjgyqësi e domosdoshme.

Në ri vendosje, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që fillimisht të kërkoj nga pala e paditur sigurimin e aktvdekjes sipas detyrimit të pranuar nga seanca e datës 13.04.2023, dhe pas sigurimit të aktvdekjes të njëjtën mbi t'ia dorëzoj palës paditëse dhe njëkohësisht ta urdhëroj të njëjtën që brenda afatit ligjor prej 3 ditësh të rregulloj padinë në anën e legjitimitetit pasiv të të paditurit varësisht nga përmbajtja e aktvdekjes, dhe pas plotësimit të këtyre kushteve ligjore, të vazhdoj procedurën gjyqësore dhe pas nxjerrjes dhe administrimit të të gjitha provave, vërtetimit të drejtë dhe plotë të gjendjes faktike të nxjerr vendim meritor në këtë çështje juridike.

Meqë, u anulua aktvendimi sa i përket kërkesës kryesore, atëherë anulohet edhe vendimi për shpenzimet e procedurës, dhe në procedurën ri gjyqësore udhëzohet gjykata e shkallës së parë që varësisht nga suksesi i arritur në procedurë dhe rrethanat tjera, të vendos përfundimisht për shpenzimet e procedurës.

Prandaj, nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 208 dhe 209, pika (d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 7435/23, data 25.03.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka